

AKT – THEMELIMI

i

Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

“ DIEFFE sh.p.k ”

1

Në Kavajë, më 28 Shkurt 2025

Une;

Davide Toffoli, i datëlindjes 26.04.1983, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr YC 5675366 me shtetasi Italiane, mbajtes i Leje Qendrimit Shqiptare me nr I33426003W banuese në adresën: KAVAJE, KAVAJE Rr: Nd :132, Nr ap :1 2501 Kavaje, njohes i gjuhes shqipe.

bazuar në aktet ligjore:

Ligji nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”,

vendosa themelimin e shoqërisë me:

Neni 1

EMRI SHOQËRISË

Të themelojmë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar për të ushtruar veprimtari ekonomike e emëruar:

Emri Shoqërisë është **“DIEFFE sh.p.k ”**

Neni 2

FORMA JURIDIKE

Shoqëria **“ DIEFFE sh.p.k ”** është e formës juridike Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (shpk):

Neni 3

Shoqëria do të ketë vulën e saj, ku janë përcaktuar dhe inicialet e emërimit të saj

Neni 4

SELIA

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën:



KAVAJE, KAVAJE Rr: Nd :132, Nr ap :1 2501 Kavaje.

Ajo ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, filiale, agjenci, përfaqësi, seli sekondare si dhe t'i suprimojë ato.

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:
david@naturalifood.com

2

Neni 5
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa kufizim.

Neni 6
KAPITALI THEMELTAR FILLESTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është në lekë 100,000 (njëqindmijë) Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e mëposhtëm:

- **Ortaku i vetem Davide Toffoli është zotëruese e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme në lekë 100,000 (njëqindmije) që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.**

Neni 7
Në librin e llogarisë, që do të krijohet në Shoqërinë Tregtare, do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga ortakët. Rritja e kapitalit të ortakëve nuk është e kufizuar.

Neni 8
Të gjitha pjesët e kapitalit themelor janë tërësisht të shlyeshme dhe të nënshkrueshme nga ortaku i vetëm i Shoqërisë.

Neni 9
ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.



Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 10

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 11

OBJEKTI VEPRIMTARISË

Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar (shpk) "DIEFFE sh.p.k" do ta ushtrojë veprimtarinë e saj me objekt:

Call center

Neni 13

ORGANI VENDIMMARRES

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;



- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 14 ADMINISTRIMI

Asambleja e përgjithshme emëron administratorët e shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesi (QKB).

Administratori shoqërisë deri në fitimin e zotësisë juridike pë të vepruar caktohet z. Myrteza Babamusta.

Asambleja përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 15 LIBRAT DHE REGJISTRAT

Shoqëria do të mbajë dhe do të ruajë sipas afateve ligjore librat dhe regjistrat e saj, do të mbajë procesverbalet e mbledhjeve sipas formës dhe përmbajtjes përcaktuar në dispozitat përkatëse ligjore.

Neni 16 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;



- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB);
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të theksin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 17

PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen,

për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 18 VITI FINANCIAR

7

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 19 PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB)";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueze, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 20 RIORGANIZMI I SHOQËRISË, BASHKIMI, NDARJA

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Bashkimi shoqërisë me një apo disa shoqëri të tjera, nuk mund të bëhet pa miratimin paraprak me Vendimi të Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve zotërues të 100 % të kutave të kapitalit të shoqërisë.

Neni 21
TË PËRGJITHSHME

Ky Akt - Themelimi ka 21 dispozita, u hartua në gjuhën shqipe në ekzemplarë të njëjtë, miratohet e nënshkruhet me vullnetin e lirë nga :

ADMINISTRATOR
MYRTEZA BABAMUSTA

ORTAKU THEMELUES
i SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“DIEFFE sh.p.k”

Myrteza Babamusta 

(Davide Toffoli)

Emër, mbiemër, nënshkrimi

DAVIDE TOFFOLI 